



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA KURBIN

Nr. 2074/Prot
14

Laç me 01/09/2016

KONTRATE SIPERRMARJE PUNIMESH

Objekti: “Rikonstruksion i Shkolles se Mesme “At Shtjefen
Gjeçovi” Laç, Bashkia Kurbin”

E lidhur me date: 01/09/2016

MIDIS

BASHKISE KURBIN Perfaqesuar nga Kryetari ARTUR BARDHI

Dhe

Sipermarresit : Bashkimi i Operatoreve ekonomik “SENKA” shpk
& “NDREGJONI” & “EGLAND” shpk, Perfaqesuar me prokure nga
“SENKA” shpk me administratore Donika SENKA

Nr. 2074/Prot
114

5323
dat. 01.09.2016

Laç me 01/09/2016



KONTRATE - SIPERMARRJE

Lidhur sot me date 01/09/2016 ne Bashkine Kurbin midis Paleve:

-Bashkia KURBIN me seli ne LAÇ e perfaqesuar nga Kryetari Z. ARTUR BARDHI i quajtur "INVESTITOR"

Dhe

-Operatorit Ekonomik "Bashkimi i Operatoreve ekonomik "SENKA" shpk & "NDREGJONI" & "EGLAND" shpk, Perfaqesuar me prokure nga "SENKA" administratore Donika SENKA.Sh.p.k." i quajtur "SIPERMARRRES" /Kontraktor.

- Objekti i kontrates: **Rikonstruksion i Shkolles se Mesme "At Shtjefen Gjeçovi" Laç, Bashkia Kurbin**

IV.-Baza ligjore:Neni 850 e vijues i Kodit Civil te vendimi te Komisionit Vlersimit te Ofertave NrDate2016 . te miratuar nga Kryetari i Bashkise ne date2016 Vendimi i Kryetarit te Bashkise Nr ... date2016 per ngritjen e komisionit te vleresimit te ofertave Urdheri i prokurimit Nr.....date.....2016.Ligji Nr 9643 date 20.11.2006 i ndryshuar "Per prokurimin Publik" dhe V.K.M. Nr.914, datë 29.12.2014. " Per miratimin e rregullave te prokurimit Publik"

V.-Vlera e kontrates

Kontrata lidhet me vlere 129.487.463,06 (Njeqind e njezet e nete milion e katerqind e tetedhjete e shtate mije e katerqind e gjashtedhjete e tre pike zero gjashte) leke pa tvsh

Vlera e financimit per vitin 2016 eshte 65 000 000 leke pa TVSH, dhe 78 000 000 leke me TVSH, dhe

Vlera e financimit per vitin 2017 eshte 65 487 463.06 leke pa TVSH, dhe 77 384 955,67 leke me TVSH, referuar shkreses Nr.5275 prot, date 23.05.2016 "Dergohet per zbatim" te Ministrise se Arsimit dhe Sportit.





VI. Afati i kontrates:

Afati i perfundimit te punimeve eshte **6(gjashte) muaj ose ditë 183 (Njeqind e tetdhjete e tre) dite pune** nga data e fillimit te punimeve qe do te jete data kur Sipermarresi do te mari ne dorzim me anene e nje procesverbali lirim kantjerin e ndertimit .

Data e fillimit eshte data kur kontraktori do të filloje punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, "data e fillimit "do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.

Ky afate perlllogaritet ne dite pune efektive ne vartesi te rialokimit te fondeve qe do te behen nga Buxheti i Shtetit

Afati i realizimit te punimeve do të thotë data që punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.

Data e Parashikuar e Perfundimit te Punimeve eshte data ne te cilen kerkohet qe Kontraktuesi te perfundoje Punimet. Data e parashikuar e perfundimit te Punimeve eshte specifikuar ne te Dhenat e Kontrates dhe mund te rishikohet vetem nga Drejtuesi i Projektit, i cili leshon nje urdher per zgjatjen e afatit, ndryshim ose pershpejtim.


VII. Marrja ne dorezim i Vendit te Punimeve

Investitori do t'i jape ne dorezim Kontraktorit te gjitha pjeset e Vendit te Punimeve. Ne qofte se dorezimi i nje pjese nuk eshte bere brenda dates se caktuar ne te Dhenat e Kontrates, do te konsiderohet se Punedhensi do te kete vonuar fillimin e veprimtarive dhe kjo do te perbeje nje Rast qe kerkon Kompesim.

VIII. Zgjatja e Afatit te Dates se Parashikuar te Perfundimit te Punimeve.

1 - Drejtuesi i Projektit do te shtyje Daten e parashikuar te perfundimit te punimeve, ne rast se ndodh nje rast kompesimi ose eshte nxjerre nje urdherese ndryshimi, qe e ben te pamundur arrijten e perfundimit ne Daten e Parashikuar te Perfundimit pa qene nevoja qe te ndermerren hapa nga Kontraktori per te pershpejtuar punen e mbetur, e cila do t'i sjelle kontraktuesit shpenzime shtese.

2 - Drejtuesi i Projektit do te vendose nese dhe sa do te zgjase afatin e Perfundimit te Punimeve brenda 21 diteve pasi Kontraktori t'i kete kerkuar Drejtuesit te Projektit vendimin mbi efektin e Rastit te Kompesimit ose Ndryshimit duke dhene nje informacion te plote sqarues. Ne qofte se Kontraktori nuk ka mundur te jape nje njoftim mbi vonesen ne kohen e duhur, kjo vonese nuk do te merret parasysh ne vleresimin e Dates se Re te Parashikuar te Perfundimit te Punimeve.





Palet bien dakort si me poshte

1- Sipermarresi Bashkimi i Operatoreve *“SENKA” shpk & “NDREGJONI” shpk & “ENGLAND” shpk*, eshte dakort te zbatoje objektin e kontrates sipas preventivit dhe specifikimeve teknike te dhena ne projektin e zbatimit: *Rikonstruksion i shkolles se mesme “At Shtjefen Gjeçovi” Laç, Bashkia KURBIN me vlere:129.487.463,06 (Njeqind e njezet e nete milion e katerqind e tetedhjete e shtate mije e katerqind e gjashtedhjete e tre pike zero gjashte) leke pa tvsh*

Dhe Afati i realizimit te punimeve 183 (njeqind e tetedhjete e tre) dite pune kalendarike





Sipermarresi do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier
Sipermarresi do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike te rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin

2- **Investitori** Bashkia Kurbin Autoriteti Kontraktor do t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në kete kontrate. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkoje amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes ne kantjer qe do te jete data e fillimit te punimeve.

Çmimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat paraprake (ne se ka) , duhet të paguhet siç specifikohet në kontratë.

2.GJUHA E KONTRATES.

Gjuha ne te cilen perpilohet kontrata eshte gjuha Shqipe.Te gjitha materialet ne kete kontrate do te jene ne gjuhen shqipe. Gjuha e Kontrates dhe ligji ku do te mbeshtetet kjo Kontrate jepen ne te dhenat e kontrates.



3-KOMUNIKIMI

Komunikimi midis paleve qe permenden ne Kushtet e Kontrates do te jete i vlefshem vetem kur behet me shkrim. Njoftimi do te jete i vlefshem vetem pasi te jete derguar

4-PREVENTIVI

4.1. Preventivi do te perfshije te gjitha zerat e punimeve te parashikuara per zbatimin e objektit **“Rikonstruksion i Shkolles se Mesme “At Shtjefen Gjeçovi” Laç, Bashkia Kurbin”**

4.2. Preventivi do te perdoret per te llogaritur vleren e kontrates. Sipermarresi paguhet me sasine e punes se kryer sipas projektit , bazuar ne cdo ze pune te preventivit.

4.3. Preventivi do te permbaje zera per ndertimin, instalimin, testimin dhe realizimin e Punimeve qe do te behen nga Kontraktori.

4.4 .Preventivi perdoret per te perlllogaritur Cmimin e Kontrates. Kontraktori paguhet per sasine e punes se bere sipas vleres se zerave ne Preventiv.

5.RREZIQET E SIPERMARRESIT

Sipermarresi ka per detyre te perballoje te gjitha shpenzimet qe mund te dalin nga data e fillimit te punimeve e deri ne fund te periudhes se garancise per difektet qe mund te dalin ne objekt sipas te dhenave te kontrates. Sipermarresi deri ne perfundim te punimeve do te perballoje rreziqet per shkak te demtimeve personale, vdekjes dhe humbjes ose demtimit te pasurise.

6.SIGURIMET

Sipermarresi do te permbushe te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga legjislacioni ne fuqi ne Republiken e Shqiperise dhe qe lidhen me rreziqet qe sipermarresi duhet te perballoje sipas pikes 5. Sipermarresi do te mbuloje, ne emrat e perbashket te Punedhenesit dhe Sipermarresit, siguracionet nga Dita e Fillimit deri ne fund te periudhes se perfundimit punimeve , ne shumat dhe zbritjet e caktuara ne te Dhenat e Kontrates per rastet e meposhteme te cilat jane rreziqe per Sipermarresin:

- (a) humbje ose demtim i Punimeve, Kantierit, dhe Materialeve;
- (b) humbje ose demtim i Pajisjeve
- (c) humbje ose demtim i pasurise (pervec Punimeve, Kantierit, Materialeve dhe Pajisjeve) ne lidhje me Kontraten; dhe
- (d) deme personale ose vdekje.



7. DETYRIMET E SIPERMARRESIT

7.1. Sipermarresi do të kryejë punimet në përputhje me projektet e dhëna nga investitori dhe në përputhje me kushtet teknike (K.T) dhe kushtet e zbatimit (K.Z) në Republikën e Shqipërisë.

7.2. Inxhinieri zbatues i sipermarresit në kantiër është i detyruar të mbajë ditarin e objektit, ku të përfshihen të gjitha punimet e kryera dhe urdherat e dhëna për zbatimin e projektit. Ky ditarë në çdo kohë do të vihet në dispozicion Mbikqyresit të Punimeve, Grupit të Kolaudimit dhe Investitorit.

7.3. Sipermarresi do të kryejë punime në sipermarresin pasi të ketë marrë me parë miratimin e investitorit. Në çdo rast në sipermarresin është i detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet e kësaj kontrate. Përgjegjës ndaj Investitorit mbetet gjithmonë Sipermarresi kryesorë i punimeve.



7.4. Sipermarresi ka për detyrë të ruajë projektin dhe të mos e përdorë atë në objekte të tjera. Gjithashtu të mos japë informacione mbi ecurinë e punimeve pa lejen e investitorit (botim artikujsh apo fotografish).

7.5. Sipermarresi është i detyruar që me shpenzimet e veta të kryejë provat laboratorike të materialeve që do të përdoren në objekt si dhe provat e kampioneve të marrë nga objekti në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Mbikqyresi i punimeve.

7.6. Sipermarresi është i detyruar që të ndërprejë punimet kur nuk garantojnë pagesat e situacioneve Brenda 10 ditëve nga dorëzimi i situacionit të punimeve të kryera.

8. PROGRAMI

Brenda pesë ditëve nga nënshkrimi i kontratës, Sipermarresi do të paraqesë për miratim mbikqyresit të punimeve një program në të cilin tregohet mënyra e kryerjes së punimeve dhe grafiku kohor. Sipermarresi do të realizojë programin sipas grafikut të parashikuar.





9.SIGURIMI TEKNIK

Sipermarresi eshte pergjegjes per te gjitha veprimtarite ne kantierin e ndertimit, duke zbatuar masat e sigurimit teknik per te gjitha personelin. Ai eshte pergjegjes per sigurimin teknik te te gjitha veprimtarive ne Vendin e Punimeve.

10.KORIGJIMI I DEFEKTEVE

10.1 Mbikqyresi i punimeve do te njoftoje Sipermarresin lidhur me cdo defekt para mbarimit te periudhes se garancise se defekteve. Periudha e garancise per defektet eshte **12 muaj**.

10.2 Çdo here qe njoftohet nje defekt Sipermarresi do te korigjonte defektin Brenda afatit te parashikuar nga njoftimi i mbikqyresit te punimeve.

11.DEFEKTET E PAKORIGJUARA

Ne rast se Sipermarresi nuk e korigjon defektin brenda afatit te pecaktuar ne njoftimin e mbikqyresit te punimeve, ky i fundit do te vleresojë koston e korigjimit te defektit, dhe Sipermarresi do te paguaje kete shume se bashku me nje gjobe te veçante. Investitori do te mbaje kete shume duke e zbritur nga pagesa pasardhese.

12.SITUACIONET

12.1. Sipermarresi do ti paraqese Mbikqyresit te punimeve situacionin perfundimtare duke zbritur garancine e defekteve.

12.2. Mbikqyresi i punimeve do te kontrolloje punen e kryer nga sipermarresi dhe do te vertetoje shumen qe duhet ti paguhet sipermarresit brenda **10 diteve** nga paraqitja e situacionit. Vlera e punimeve te kryera do te percaktohet nga Mbikqyresi i punimeve dhe do te perfshije vleren e volumeve te zerave te punimeve te perfunduara dhe te shprehura ne preventive.

12.3 Vlera e punes se kryer do te perfshije vlerat e ndryshimeve dhe rastet e kompensuara.

13.PAGESAT

13.1. Pagesat do te kryhen pas paraqitjes se situacioneve pjesor , perfundimtare dhe dokumentacionit per punimet e kryera.



13.2 Punedhësi do t'i paguaje Kontraktorit shumat e vertetuara nga Drejtuesi i Projektit brenda 20 diteve nga data e paraqitjes së secilës certifikate. Nqs, Punedhësi e ben pagesen me vonese, Kontraktorit do t'i paguhet interesi per pagesat e vonuara ne pagesen e ardhshme. Interesi do te llogaritet nga dita kur pagesa duhej te ishte bere deri ne ditën kur behet pagesa e vonuar me kursin mbizoterues te interesit per dhenie hua tregtare per monedhen ne te cilen jane bere pagesat.

13.3 Zerat e punimeve per te cilat nuk eshte vene cmim per njesi ne oferten e paraqitur ,do te konsiderohen si te mbuluara nga vlerat e tjera te perfshira ne kontrate. Pagesat do te behen sipas çeljeve qe do te rialokohen nga Ministria e Financave

14.RASTET E KOMPENSUARA

14.1.Rastet e justifikuara per te cilat vonesa justifikohet,do te konsiderohen si vijojne:

a-Mbikqyresi i punimeve urdheron shtyrjen ose nuk jep skicat ,specifikimet ose udhezimet e nevojshme per kryerjen e punimeve ne kohen e caktuar.

b-Mbikqyresi i punimeve udhezon sipermarresin per te zbuluar punimet e fshehta ose per te kryer provat pas kryerjes se punimeve.

c-Autoriteti Publik ose Investitori shkaktojn vonesa ne lirimin e sheshit te ndertimit per sipermarresin.

ç-Investitori vonon pa arsye leshimin e certificates se marrjes ne dorezim.

14.2.Kompensimi i rasteve te siperpermendura do te behet si vijon:

Per vonesat e permendura ne pikat 18.1 (a,b,c) investitori do te njohe shtyrjen e dates mbi ate te parashikuar ne kontrate.

15.TAKSAT

15.1.Sipermarresi eshte i detyruar te paguaje te gjitha taksat ne perputhje me legjislacionin shqiptare.

15.2.Per taksat e percaktuara ne legjislacion qe kane hyre ne fuqi 28 dite para dates se hapjes se tenderit te cilat sipermarresi duhet ti kete parasysh ne vleren e kontrates).Sipermarresi nuk do te njohe asnje shtese page.



16. DEMSHPERBLIMI PER VONESAT

16.1. Sipermarresi do ti paguaje investitorit demshperblimin per vonesea ne masen 2/1000 ne dite të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, (vleres se punes se pakryer). por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.

16.2 Sasia e pergjithshme e demeve te likujduara nuk do ti tejkaloje 15% te vleres se kontrates. Invesitori do te zbrese demshperblimin per vonesat nga pagesat e fundit e sipermarresit.

17.-MARRJA NE DORZIM E PUNIMEVE

17.1 Sipermarresi pas perfundimit te punimeve njofton me shkrim mbikqyresin e punimeve dhe invesitorin dhe i paraqet mbikqyresit te punimeve dokumentacionin dhe llogaritjet perfundimtare per punimet e kryera te cilat mbikqyresi i punimeve mbas verifikimeve brenda tre diteve sebashku me relacionin e tije ja paraqet invesitorit. Invesitori ne rast se veren defekte qe jane pasoje e punes jo cilesore te sipermarresit, do te praqese verejtjet me shkrim dhe do te kerkoje riparimin e tyre brende 5(pese) diteve. Pas riparimit te defekteve ne se ka dhe korigjimeve te nevojshme ne llogarine perfundimtare te shumes totale dhe pas marrjes se procesverbalit te kolaudimit, invesitori do te leshoje çertifikaten e marrjes ne dorzim te objektit dhe do te çliroje garancine e sigurimit te kontrates.

17.2 Invesitori do te kerkoje dokumentacionin perkates per punimet e fshehta sipas preventivit dhe kushteve te kesaj kontrate. Per kete qellim mbikeqyresi i punimeve pas çdo situacioni do te relatoje me shkrim tek invesitori per cilesine e punimeve te kryera nga sipermarresi dhe materialet e montuara ne objekt, para afatit te lekujdimit te ketyre punimeve. Ne fund te punimeve, mbikeqyresi i punimeve dhe grupi i kolaudimit do te perpiloje aktin e kolaudimit te punimeve dhe sebashku me invesitorin aktin e marjes ne dorzim te vepres objekt i kesaj kontrate, si dhe grafiqet e situacionet bashke me dokumentacionin perkates bashkengjitur tekstit te kesaj kontrate.

18-GARANCIA E DEFEKTEVE

Garancia e defekteve do te jete 5% e vleres se kontrates qe ti mbahet nga çdo situacion sipermarresit si garanci per cilesine e punimeve, shume e cila do te paguhet mbas perfundimit te afatit 12 mujore nga perfundimi i punimeve dhe me eliminimin e defekteve qe mund te kene ndodhur ne kete periudhe.



19-KOSTOJA E RIPARIMEVE

19.1 Demtimi i punimeve ose humbja e materjaleve qe do te perdoren per punimet nga dita e fillimit deri ne marrjen ne dorzim te punimeve do te mbulohet nga sipermarresi me shpenzimet e tije ne qofte se humbja ose demtimet jane shkaktuar nga gabimet e veprimeve te tija.

19.2 Riparimet qe dalin te nevojshme gjate kolaudimit te vepres, ne se jane per shkak te mosplotesimit te kontrates ose te punes jo cilesore te sipermarresit do te mbulohen nga ky i fundit me shpenzimet e tija.

19.3 Sipermarresi nuk do te jete pergjegjes per lekujdimin e demeve te shkaktuara nga forcat madhore si termetet, permbytjet ose gjendjet e jashtezakonshme e deklaruar qe mund te ndodhe gjate zbatimit te punimeve te cilat jane jashte kontrollit te sipermarresit dhe qe nuk konsiderohen si neglizhenca te tije.

20-ZGJIDHJA E KONTRATES.

20.1 Invesitori ose sipermarresi mund te zgjidhin kontraten kur verejne shkelje themelore te tyre.

20.2 Shkeljet themelore te kontrates perfshijne, por nuk kufizohen ne sa vijon:

a)-Sipermarresi nuk fillon pune brenda 28 diteve nga nenshkrimi i kontrates si dhe ne rast kur ndalon punimet me shume se 28 dite kur nuk paraashikohet ne programin e punes dhe ndalimin e punimeve nuk eshte i autorizuar nga Mbikqyresi i Punimeve dhe nuk respektohet grafiku i punimeve.

b)-Mbikqyresi i punimeve udhezoi qe te shtyje perparimin e Punimeve dhe ky udhezim nuk terhiqet brenda 28 diteve duke njoftuar investitorin dhe sipermarresin.

c)-Sipermarresi ose Sipermarresi falimenton ose hyn ne procesin e likuidimit per arsye te tjera pervec rindertimit ose bashkimit.

d)- Pagesa e vertetuar nga Drejtuesi i Projektit nuk i paguhet Kontraktorit nga Drejtuesi i Projektit brenda 84 ditesh pas dates se certifikates se Drejtuesit te Projektit.

e)- Drejtuesi i Projektit dergon Njoftim se moskorrigjimi i nje Difekti te posacem perben shkeljen themelore te Kontrates dhe Sipermarresi nuk e korrigjon ate brenda nje periudhe te arsyeshme te kohes se percaktuar nga Drejtuesi i Projektit.

f)- Sipermarresi nuk mban Sigurimin qe kerkohet; dhe Sipermarresi ka shtyre kryerjen e Punimeve mbi nje numer ditesh per te cilat shuma maksimale e demshperblimeve te voneses mund te paguhet, sic percaktohet ne te Dhenat e Kontrates.



24. LEGJISLACIONI BAZE.

Ligji i aplikushmerise do te jete ligjislacioni shqiptar ne fuqi si dhe aktet nenligjore e vendimet e Keshillit te Ministrave.

25.GARANCIA E KONTRATES.

Garancia e kontrates do te jete ne masen 10% te vleres se kontrates.Kjo garanci ngurtesohet nga sipermarresi per llogari te investorit para nenshkrimit te kontrates.

Kontrata hartohet ne kater kopje te barabarta ku 3(tre) prej te cilave i mban investori dhe nje Sipermarresi.

PER SIPERMARRESIN

“SENKA .Sh.p.k.”

Dinika Senka

Administratore Ing.(Dinika SENKA)

“NDREGJONI” shpk

Xhetan Ndregjoni

Administratori (Xhetan Ndregjoni)

“EGLAND” shpk.

Administratori (Rasim DACI)



PER INVESTORIN

BASHKIA KURBIN

KRYETARI

(Artur BARDHI)

Artur Bardhi



KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS
Punët – Procedura e Hapur

**Objekti: “Rikonstruksion i Shkolles se Mesme “At Shtjefen Gjeçovi” Laç,
Bashkia Kurbin”**

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.



- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontraktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” eshte perfshire ne të dhënat e kontrates. Ajo eshte data kur kontraktori do të filloje punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit “do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhënia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor qe eshte pjese e kesaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.


- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës




- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.



15





Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së



mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor

8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.



13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vëne re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.

13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë egzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.

15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.


16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rezevizueshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 17: Zbulimet

17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 18: Disponimi i Kantierit

18.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktori i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në



- (a) dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Autoriteti Kontraktor apo nga çdo person i punësuar/kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor, përveç kontraktorit.
- (b) dëmtim të Punimeve, materialeve dhe pajisjeve deri në atë masë që lidhet me fajin e Autoritetit Kontraktor apo me projektin e tij.

Neni 24: Përgjegjësitë e kontraktorit

24.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor sipas Nenit 23.

Neni 25: Sigurimi

25.1 Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes në kantier deri në afatin e realizimit të plotë, në shumatat e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

25.2 Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky sigurim duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbrisi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.







25.3 Kushtet e siguracionit nuk mund të ndryshohen pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktor.

Neni 26: Testimet dhe Inspektimet

26.1 Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspekteve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës.

26.2 Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto teste dhe inspekte.

26.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë teste ose inspekte shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet

janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.

26.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

26.5 As ekzekutimi i testeve as inspektimi i punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

Neni 27 Garancitë

27.1 Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzojnë përmirësimet e fundit në projekt dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.

27.2 Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

Neni 28: Çmimi i Kontratës

28.1 Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

Neni 29: Kushtet e Pagesës

29.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat paraprake, duhet të paguhet siç specifikohet në kontratë.

29.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet më një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa do të bëhet me monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë në ditën kur është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe i përcaktuar në kontratë.

29.3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori ka të drejtë të marrë pagesa periodike gjatë progresit të zbatimit të projektit. Grafiku i pagesave periodike do të parashikohet në KVK. Kur bëhet një pagesë e parashikuar, kontraktori duhet të paraqesë një deklaratë me situacionin e muajit tek drejtuesi i projektit ku deklaron se plani sipas grafikut është përbushur. Komunikata gjithashtu duhet të shprehë vlerën e punës së ekzekutuar duke hequr shumën e grumbulluar të verifikuar më parë, si dhe shumën e pagesës paraprake të paguar dhe çdo shumë të mbajtur në pritje të korrigjimit të një defekti.



- 29.4 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punimet e ekzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t'i paguhet kontraktorit, brenda 20 ditëve pune nga data që kontraktori paraqet komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit.
- 29.5 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa e periodike për Punët do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga drejtuesi i projektit.
- 29.6 Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

Neni 30: Vonesa në Bërjen e Pagesës







- 30.1 Shperblimi per demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamaten e arritur nga data e fillimit te vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bërë llogaritja e tyre.
- 30.2 Kamata ligjore paguhet pa qene i detyruar kreditori (kontraktori) te provoje ndonje dem. Nëse kreditori (kontraktori) provon se ka pesuar nje dem me te madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktor) duhet të paguajë pjesën e mbetur të demit.

Neni 31: Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

- 31.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 32: Forca Madhore

- 32.1 Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit te kontrates, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.
- 32.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.
- 32.3 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Blerësin Publik. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme,



kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 33: Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

- 33.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.
- 33.2 Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit së Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.
- 33.3 Autoriteti Kontraktor mund të zbrisë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
- 33.4 Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.
- 33.5 Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkaku dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

Neni 34: Dëmet e Likuidueshme për Vonesën në Mbarimin e Punimeve

- 34.1 Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:
- Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
 - Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
 - Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 35: Negociatat dhe Amendamentet

23



FORMULARI I KONTRATËS

Titulli i Kontratës: **“Rikonstruksion i Shkolles se Mesme “At Shtjefen Gjeçovi” Laç, Bashkia Kurbin”**

Kjo Kontratë është lidhur më [data _____ 2016], midis [Bashkise Kurbin] tani e tutje të referuar si “Autoriteti Kontraktor” dhe [Bashkimi i Operatoreve ekonomik “SENKA” shpk & “NDREGJONI” & “EGLAND” shpk, Perfaqesuar me prokure nga “SENKA” shpk me administratore Donika SENKA], tani e tutje i quajtur si “SIPERMARRESI”.

Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor paraqet një kërkesë për Realizimin e Punëve, duke i'u referuar

Prokurimit (objekti) **Rikonstruksion i Shkolles se Mesme “At Shtjefen Gjeçovi” Laç, Bashkia Kurbin”**

Menjëherë pasi Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë [data 03.08.2016] bie dakord të realizojë Punët, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:

1. Këtë Formular Kontrate
2. Formularin për Ofertë, të paraqitur nga Ofertuesi
3. Kërkesat e pergjithshme te Pranimi/Kualifikimit
4. Programin Përfundimtar dhe Specifikimet Teknike
5. Preventivin e Kostove
6. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
7. Kushtet e Veçanta të Kontratës
8. Njoftimin e Fituesit nga Autoriteti Kontraktor
9. Formularin e Sigurimit të Kontratës

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitur përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate. Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor pranon Ofertën nga Kontraktori, në një shumë prej **129.487.463,06 (Njëqind e njetzet e nete milion e katerqind e tetedhjetë e shtatë mijë e katerqind e gjashtedhjetë e tre pike zero gjashtë) leke pa tvsh** për realizimin e Punëve;

Palët bien dakort si më poshtë:

1. Kontraktuesi duhet të paraqesë një Sigurim Kontrate në shumën prej: **12,948,746 (dymbëdhjetë milion e nenetëqind e dyzet e tete mijë eshtateqund e dyzet e gjashtë) leke pa tvsh** dhe në formën e: garancese bankare ose me agjensi sigurimesh ose përpara datës së shprehur në Njoftimin e Fituesit.

2. Kontraktuesi është i detyruar të kryejë Punët për Autoritetin Kontraktor, siç kërkohet në këtë Kontratë.

3. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të paguajë për Punët, në shumën e parashikuar në këtë Kontratë.

4. Në këtë Formular Kontrate, fjalët dhe shprehjet do të kenë të njëjtin kuptim që i ngarkohet atyre në Kushtet e Kontratës.
5. Palët e kësaj Kontrate kanë përgjegjësi për moszbatim ose zbatim të papërshtatshëm të detyrimeve të tyre kontraktore dhe për dëmet e shkaktuara secilës nga moszbatimi i detyrimeve, që janë subjekt kompensimi, në përputhje me Kushtet e Kontratës.

Sot, më datë ___/___/2016/ palët bien dakort për nënshkrimin e këtij Formulari Kontrate.

Tel:.....

Tel:.....

PER SIPERMARRESIN

"SENKA .Sh.p.k."

Dinika Senka

Administratore Ing. (Dinika SENKA)

"NDREGJONI" shpk

XHETAN NDREGJONI

Administratori (Xhetan Ndregjoni)

"EGLAND" shpk.

Administratori (Rasim DACI)

PER INVESTITORIN

BASHKIA KURBIN

KRYETARI

(Artur BARDHI)

